



SIGURIA RRUGORE PËR FËMIJËT

Siguria në rrugë, siguria për jetën!

Rregullat e qarkullimit rrugor nuk janë vetëm për drejtuesit e automjeteve, por për të gjithë ne!!

MBRO JETËN TËNDE!

Si duhet të ecim në rrugë?

➡ Përdorni trotuarin ose çdo sipërfaqe të caktuar për lëvizjen e këmbësorëve ;

Nëse duhet të kaloni rrugën ndiqni rregullat e mëposhtme:

➡ Ndalo të gjesh një vend të sigurtë ku do ta kalosh rrugën;

➡ Qëndro në anë të rrugës, mbi trotuar;

➡ Shiko gjithmonë rreth e rrotull për mjetet që lëvizin dhe dëgjo me vëmendje;

➡ Rrespekto sinjalistikën rrugore (semaforin, tabelat etj);

➡ Mos u shpërqendro duke biseduar në telefon, shkruar sms apo dëgjuar muzikë



Si të udhëtoni të sigurtë në autoveturë :

➡ Kur hipni në autoveturë ose zbritni, përdor derën nga ana e kundërt e lëvizjes së automjeteve;

➡ Vendos rripin e sigurimit para se autovetura të nisët;

➡ Nëse je nën moshën 12 vjeç, dhe me gjatësi trupore nën 150 cm, mos udhëto në ndenjësën e parë;



- ➡ Kur autovetura është në lëvizje mbaje dorën larg dorezës që hap derën;
- ➡ Mos e nxirr dorën a kokën jashtë dritares;
- ➡ Mos hidh sende nga dritarja, sepse ndot mjedisin dhe rrezikon jetën e të tjerëve;
- ➡ Mos e shpërqendro drejtuesin e mjetit (me fjalë, zënka etj).

Si të ngisni të sigurt biçikletën:

- ➡ Asnjëherë mos lëviz me biçikletë, që është më e madhe ose më e vogël për ty!
- ➡ Kontrolllo frenat, rrotat, gomat, timonin, zinxhirin dhe bindu se janë në rregull - pastaj nisu;
- ➡ Mos lëviz asnjëherë me biçikletë pa kaskë;
- ➡ Mos lëviz asnjëherë natën pa jelekun fosforeshent;
- ➡ Lëviz gjithmonë në krahun e djathtë të rrugës ose në korsitë e dedikuara për biçiklistët.



*Punonjësi i Policisë kujdeset për sigurinë tuaj në rrugë!
Kërko dhe zbato gjithmonë këshillat e tij!*

*Raporto shkelësit e rregullave të qarkullimit rrugor,
që me veprimet e tyre rrezikojnë jetët e të tjerëve!
MOS JI INDIFERENT!*

Ky numër është në shërbimin Tuaj pa pagesë

Telefono
129

Financuar nga
Programi Suedez për
Policimin në Komunitet

